

Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në University of West Attica, (UNIWA), Greqi

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of West Attica, Greqi.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Të kenë përfunduar një vit akademik, Bachelor.)
- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master, në Universitetin Politeknik të Tiranës.)

Kohëzgjatja e bursave:

- 4 muaj, semestri i II i vitit akademik 2024 - 2025

Fushat e studimit: Të gjitha degët. Sipas lëndëve të ofruara nga UNIWA.
Course Catalogue: <https://erasmus.uniwa.gr/en/erasmus/course-catalogue/>

Numri total i studentëve për mobilitet - 2 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë*

“Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of West Attica, Greqi, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Bashkëlidhur gjendet formati i “Learning Agreement dhe informacioni mbi katalogun e lëndëve që ofron UNIWA.

[Learning Agreement](#)

<https://erasmus.uniwa.gr/en/erasmus/course-catalogue/>

Për një informacion të plotë mbi UNIWA, ju lutemi klikoni te:

[1st Student Guide](#)

Afati për aplikim për studentët: Deri më 8 nëntor 2022

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit, në Rektorat.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al